



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S Ë

**BASHKIA KOLONJË
KESHILLI I BASHKISE**

PROTOKOLLI 6

REND – DITE:

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes , sipas nenit 53,pika 5 ,ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 29.04.2024 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. Projekt-Vendimi “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin prill 2024, që nuk kanë marre piket e mjaftueshme nga fondi i kushtezuar për bllok ndihmën deri 6%”
4. Projekt-Vendim “Për dhenien e titullit të nderit **Z. QEMAL MINXHOZI**
5. Projekt-Vendim “Për dhenien e titullit të nderit **Z. MARK STOSCHER**
6. Projekt-Vendim “Për shpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr.158, datë 20.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2024 dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18 datë 26.02.2024 “Për miratimin e Buxhetit Shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2024”.
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e këshillit ekonomik në Bashkinë Kolonjë.”
8. Projekt-Vendim “Për kalimin e punonjësve të drejtorisë së Pyjeve Parqeve dhe Rekracionit dhe Inspektorit të Mbrojtjes së Territorit nga nënpunës civil në punonjës me Kod Pune”.
9. Projekt-Vendim “Për miratimin e numrit të përgjithshem të punonjësve shkak të ristrukturimit të Bashkisë Kolonjë.”
10. Projekt-Vendim “Mbi propozimin dhe miratimin paraprak nga Këshilli i Bashkisë Kolonjë të disa parcelave të fondit pyjor për dhënie në përdorim”.
11. KËRKESË.

Protokolli i mbajtur sot datë 24.05.2024 në mbledhjen e radhës sipas njoftimit të dhënë në datën 17.05.2024.

Të pranishëm:E.Isai ,E.Xhelili, B.Jashari,P.Çunge, S.Kodra,E.Avdi,S.Larti,E.Çikopana,I.Milo,
G.Tafili,T.Çaçani,I.Hodo.

Mungon:H.Iljazi ,Z.Meto,A.Tartari,A.Zeneli.

E.Xhelili:Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e radhës,pika e pare e rendit të ditës.Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili:Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës, për miratimin e proces-verbalit të mbledhjes së datës 29.04.2024 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefektit.Shkresa e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefektit nuk është paraqitur nga institucioni i Prefektit.

E.Xhelili:Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili:Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës për miratimin e ndihmës ekonomike të familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin prill 2024, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtezuar për bllok ndihmen deri 6%.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili:Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës për dhenien e titullit të nderit **Z. QEMAL MINXHOZI**.

B.Jashari:Unë e njoh personalisht Z.Qemal Minxhozi, ka dhënë kontribute për Kolonjën.

S.Larti: Unë nuk shoh që ka bërë diçka për Kolonjën, nuk jamë dakortë me projekt-Vndimin.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

I.Hodo:Unë jam dakort me Z.S.Larti, Vota ime është Kundër.

T.Çaćani: Dhe vota ime Kundër

Pro 8 kundër 3 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës për dhenien e titullit të nderit **Z. MARK STOSCHER**.

S.Larti :Jam dakort me Z.Mark Stoscher.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili: Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës “Për shpërndarjen e fondevit buxhetore në vendimin nr.158, datë 20.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2024 dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18 datë 26.02.2024 “Për miratimin e Buxhetit Shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2024”.

I.Hodo:Mund të na japësh ndonje informacion?

G.Duka:Kjo është një projekt-Vendim për rishpërndarjen Buxhetore.

E.Isai:Në disa fshatra OSHE-ja modernizoj rrjetin elektrikë dhe për pasoj gjith sistemi elektrik i ndricimit publik doli jashtë kontrollit,na ka ndodhur ne fashatin Qinam,Selenicë,Rehovë pra ne dueht të investojm ne për të lidhur fsahtrat me sistem ndricimi, kemi lënë fond për të plotesuar aty ku mendojmë ne qe mungon dicka,ka mos realizim pagash sepse ne kemi tetë vende bosh tek sektori i Urbanistikës dhe momentalisht kemi ter punonjës. Fondi i pagave kalon për shërbime.

G.Duka: Matrejale ndertimi për lyerjen dhe rikonstruksion e Qëndrës Sociale, kontributi i Qarkut.

E.Isai:Kontributi i Qakrut është këshilli i Qarkut ka marrë një vendim për dy projekte të reja muzeu i Leskovikut dhe mobilimin e infopoint ata investojnë 80% dhe ne bashkfinancojm 20%.

I.Hodo: Doja të shtoja dicka në qoftë se është mundësia siç u be vitin e kaluar shtrimi i trotuareve, sepse te lagjia ku une jetoj kalojnë të gjitha makinat për në fshatin Rehovë ,është bere rruga skandal dhe fëmijt kemi frikë te dalin në lagje.

E.Isai: Pas mbarimit të asfaltimit në fshatin Mollas do filloj asfaltimi i qytetit, ne synojm që pas prishjes se barangave rrugen e Rehoves ta kalojm aty.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili: Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës“Për miratimin e këshillit ekonomik në Bashkinë Kolonjë.”

E.Isai: Ne jemi duke aplikuar në GIS dhe jemi në certifikim e siper për të bashkim miqësor me biznesin, në Ballkan rrëth 20 Bashki janë në këtë projekt dhe ende asnjë bashki Shiptare e çertifikuar. Në Shqipëri janë tetë Bashki dhe një nga tete Bashkitë jemi ne, është një nga kriteret që ne duhe ta plotësojmë, në qoftë së ne arrijme të certifikohemi na ndihmojnë në shumë projekte.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili: Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës “Për kalimin e punonjësve të drejtorisë së Pyjeve Parqeve dhe Rekracionit dhe Inspektorit të Mbrojtjes së Territorit nga nënpunës civil në punonjës me Kod Pune”.

E.Isai: Kjo është një VKM që është marrë, është sjellë udhezimin nga inspektoriati dhe nga komisioneri që tashmë punonjesit do trajtohen me Kod Pune.

I.Milo: Kjo është me VKM, spese me dukej e pa drejtë.

E.Isai: Bashkia nuk ka kontribuite mbi ndarjen e klasave te rekrutimit të punonjësve, ne e zbatojm atë cka na dërgojn Komisionerët.

L.Joti: Është një VKM që ka ardhur me shkresë nga Komisioneri.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili: Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës“Për miratimin e numrit të përgjithshem të punonjësve shkak të ristrukturimit të Bashkisë Kolonjë.”

E.Isaj: Ditën e djeshme besoj ju e keni ndjekour ne televizor, kjo është faza e parë e ristrukturimit për institucionin ,Bashkitë po kalojnë ne një rikonstruktim strukturash në rang kombëtar ndarë sipas kategorisë dhe prej datës 1 Korrik do kemi një ritje të konsiderueshme pagash. Sot do të miratojmë numrin e ri të punonjësve dhe pas miratimit nga qeverija do ta sjellim dhe njëherqë strukturën për tu miratuar,nga ku e njëjtë strukture e ndarë ne tre kategori. Ne kemi rritur numrin e punonjësve në bashki per shkak se shumë shpejt ne do te krijojm dy agjensi, një per trajtimin e arroreve dhe një agjensi për mbjelljen e fidanishteve.

L.Joti: Pas miratimit nga institucioni i Prefektit do ta gjenin faqen e web-it

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 11 kundër 0 Miratohet.

E.Xhelili: Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës“Mbi propozimin dhe miratimin paraprak nga Këshilli i Bashkis Kolonjë të disa parcelave të fondit pyjor për dhënie në përdorim”.

E.Isai: Kjo është një rutinë që ne kemi bërë disa here,pas verifikimit nga ASHK-ja.

E.Xhelili: Pasi Z.P.Çunge ka konfikilt interesit tërhiqet nga votimi.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 kundër 0 Abstenim 1 Miratohet.

E.Xhelili: Kërkesa nr 1 vjenë nga shoqata Kolonja për dhenien e Titullit nderi z.Ali Ali.

S.Lari: Kérkesa vjenë pér heren e disatë në këshillin bashkiak dhe ështe e hedhur poshtë si kérkesë nga keshilli i vitit 2015-2019.

E.Isai: Unë mendoj që kerkesën tjua kalojmë Komisioneve.

G.Tafili: Ka dhe dicka, nese i japim titullin Qytetar Nderi zotërisë, atëherë e meritojnë titullin të gjithë pronarët që kanë firmë ndërtimi.

E.Xhelili: Kérkesa tju kalojë komisioneve përpara se të vijë në Këshillin Bashkiak..

E.Xhelili: Kérkesa nr 2 vjen nga banorët e fashtit Milec.

E.Isai: Unë do të sygjeroja që të ngrihet një grup pune, ne e kemi ngritur disa herë dhe nuk kemi vendimmarrje, ai është koncesioni i qeverisë Shqiptare.Nuk janë kopetence të pushtetit lokal.

I.Milo: Të kthehet përgjigje nuk është kopetencë e këshillit Bashkiak.

E.Xhelili: Kérkesa nr 2 vjen nga Z.Zylyftar Byrekas.

E.Isai: Unë ju bëj thirje gjithë qytetarëve që dua të investojnë në Kolonjë që ish shkolla,ish zyra komunsh që duan të investojnë në agroturizëm e kanë derën e hapur, janë godina që po amortizohen.

I.Hodo: Ne kemi kënaqesin që të shohmi investime në Kolonjë.

E.Xhelili: Këshilli i jep dakortësin z.Zylyftar Byrekasi pér të vazhduar procedurat.

E.Xhelili:Kemi dhe dy peticione drjetuar Këshilli Bashkiak nga banoret e qytetit Ereskë ne lidhje me prishjen e barangave.

E.Isai: Unë prej ditës së martë do bez një sërë degjesash me komunitetin, ajo cka duhet të dini diçka që këto lloj godinash nuk do jenë me në qytetin e Ersekës.Ne e kemi pér detyrë të asistojme në shërbim që do të thote agjensia që do të ofrojë drutë e zjarrit do jetë 24 ore në shërbim të banorëve. Këto baranga prishin strukturen e qytetit, dali gjarprinjë rrëth barangave. Unë jam i idese që jasht vijes së verdhe të ndertohen të tilla baranga.

Proces-Verbali i datë 24.05.2024 është firmosur nga 11 antarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT

INSUIDA ORHANAS

KRYETAR I KËSHILLIT

ERALDO XHELILI

